



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 52 Prot.

Tiranë, më datë 07.02.2019

**VENDIM**

**Nr. 37, datë 07.02.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RESTAURIMIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 07.02.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e manualit të arredimit urban në zonën TID Vlora, pjesë e projektit "Rikualifikimi në zonën e mbrojtur urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë: Hartimi i projektit urban, restaurimi i monumenteve të kultures në këtë zonë dhe rikonstruksioni i objekteve të tjerë", Vlorë, me subjekt aplikues AADF.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**

